



Deçan, me 01.07.2016

KOMUNA DEÇAN

Ftesë për Shprehje te interesit

Komuna Deçan - njofton të gjithë të interesuarit persona fizik dhe juridik që të shprehin interesin për marrje në bashkë menagjimin me Komunen në afat prej 1-10 vite Klubin Futbollistik KF "Deçani" të regjistruar sipas Vendimit nr 01-13-33 të datës 28.07.2010 dhe Qertifikata e regjistrimit nr 5113070-7 të datës 30.09.2010.

Komuna në pamundësi të financimit të KF "Deçani" për shkak të shkurtimeve buxhetore është e detyruar që të fton të gjithë të interesuarit – persona fizik dhe juridik shtetas të Republikes së Kosovës që të shprehin interesin e tyre për marrje në bashkëmenagjim me komunën klubin në fjalë, por gjithmonë duke u harmonizuar me Vendimet e UEFA-së dhe Ligjin e Sportit të Republikes së Kosovës.

Palet e interesuara për shprehje të interesit duhet të plotesojnë keto kushte:

- Personat juridik të paraqesin certifikatat e regjistrimit të biznesit, tvsh, numrit fiskal
- Personat fizik qertifikatën e shtetësisë dhe kopjen e letërnjoftimit
- Të gjithë të interesuarit të dorëzojnë në kopje fizike dhe elektronike planin e menagjimit të klubit në afat me së paku 5 vjeçar,
- Të gjithë të interesuarit duhet të dokumentojnë aftësinë financiare për mbështetje të planit të biznesit për menagjim të klubit, (garancion bankar)
- Të gjithë të interesuarit duhet të kenë të bashkangjitur në planin e menagjimit të klubit edhe stafin teknik profesional të licencuar- trajner, ndihmes trajner dhe stafin tjetër përcielles
- Përqindja (%) e bashkë menagjimit dhe financimi nga të gjithë të interesuarit nuk mund të jete më e madhe se 70%

Kriter për përzgjedhjen e ofertës me të mirë është ofrimi i % me të lartë dhe plani i biznesit me i favorshëm për KF "Deçani"

Të gjithë të interesuarit për Shprehje të Interesit ftohen që dokumentacionin për aplikim ta dorëzojnë jo më vonë se data 08.07.2016 në ora 10:00, në Zyren pritëse të Komunes. Hapja e ofertave do të bëhet me datën 08.07.2016 në ora 11:00 në sallën e katit III- Komuna Deçan.

Komisioni Vlersues ;

Kjo shpallje do të publikohet:

- ueb faqen zyrtare të Komunës së Deçanit: kk.rks-gov.net/decan
- tabelën e shpalljeve publike të Komunës

